

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ancelotti fyen Indinë e futbollit, trajneri i Kombëtares vendase diplomat: "Nuk më intereson"
ADRESA	https://lapsi.al/ancelotti-fyen-indine-e-futbollit-trajneri-i-kombetares-vendase-diplomat-nuk-me-intereson-i1094443
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 10:15:31 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 10:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1394ff6d7942a9a827ea6256c1fe266d834e819501323a2e20209eb9d2037d52
TEKSTI	a6b35fff07595df70dc05807531c9a31ee2d3cd6093c151c846d31fc27bbc44d
PAMJA	ecf2b46468b94e0ecb41a9cda7d397f32f18ca131722fd337810168af0e49e2d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0a2072d2f658d030d419d9cce50c21b2b4d09936ecb939150c69a3f817553937
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5232afb02d0ef3cfba4c89fffc05e27ccc8e2122c3335e6361f8bbb2dc579865
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0a2072d2f658d030d419d9cce50c21b2b4d09936ecb939150c69a3f817553937>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Ancelotti fyer Indinë e futbollit, trajneri i Kombëtares vendase diplomat: "Nuk më intereson"

Pragndeshja mes Indisë dhe Brazilit u pasurua nga një përballje në distancë mes dy trajnerëve. Nga njëra anë Carlo Ancelotti, trajneri i Seleçãos, dhe nga ana tjetër Khalid Jamil, në krye të kombëtares indiane.



LAPSI.AL • 25 SEPTEMBER 2026



Pragndeshja mes Indisë dhe Brazilit u pasurua nga një përballje në distancë mes dy trajnerëve. Nga njëra anë Carlo Ancelotti, trajneri i Seleçãos, dhe nga ana tjetër Khalid Jamil, në krye të kombëtares indiane. Në qendër të diskutimit është pozicioni i Indisë në renditjen e FIFA-s dhe, në përgjithësi, raporti i vendit me futbollin.

Brazili do të mbërrijë në ndeshjen e 3 tetorit si favorit i madh. Ndeshja do të luhet në Salt Lake Stadium të Kalkutës, impiant që mund të presë rreth 85 mijë spektatorë. Seleção aktualisht zë vendin e pestë në renditjen e FIFA-s, ndërsa India ka rënë deri në vendin e 138-të.

Një diferencë e madhe, sidomos duke marrë parasysh përmasat e vendit aziatik, i cili me më shumë se 1,4 miliardë banorë është më i populluari në botë. Pikërisht kjo distancë mes potencialit demografik dhe rezultateve në futboll e ka shtyrë Ancelottin të shprehë opinionin e tij.

Ancelotti: "India nuk ka kulturë futbollit"

Pak ditë para ndeshjes, italianit Ancelotti iu kërkua të thoshte nëse ishte i befasuar nga pozicioni i Indisë në renditjen ndërkombëtare, pavarësisht popullsisë së madhe të vendit. Përgjigjja e trajnerit të Brazilit ishte mjaft e drejtpërdrejtë: "Besoj se është një çështje kulturore. India nuk ka kulturë futbollit, por shkëlqen në sporte të tjera. Duhet të punohet në këtë aspekt për të ndërtuar një brez të ri lojtarësh".



ide



Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm

Andi Bushati



Rënia e Vlorës në shtratin e krimit

Armand Shkullaku

MOTIRANA

17°C

KËMBIMIEURO

91.50

aktuale

08:49

Rama në OKB, në fokus Bordi i Paqes dhe çështja e ish-krerëve të UÇK-së

07:52



Rama sot në OKB, pritet fjalimi në Asamblenë e Përgjithshme



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku





Ancelotti më pas e zgjeroi diskutimin te mundësia e përballjes me realitete të ndryshme futbollit, duke theksuar se sa e dobishme mund të jetë për Brazilin të përballlet me kombëtare me karakteristika të ndryshme: “Duhet të përballemi me vende dhe kultura të tjera. Jemi mësuar të luajmë ndeshje miqësore me stile të ndryshme loje. India do të jetë një sfidë interesante. Është e vërtetë që India nuk ka shumë përvojë (në përballjet me kundërshtarë të nivelit botëror), por është e rëndësishme për ne të kuptojmë se si luajnë”.

Përgjigjja e Jamil: “Nuk më intereson”

Fjalët nuk mbetën pa përgjigje. India po kalon një periudhë të vështirë. Kombëtarja nuk arriti të kualifikohet për Botërorin 2026 dhe gjithashtu humbi mundësinë për të marrë pjesë në Kupën e Azisë 2027. Renditja e FIFA-s pasqyron vështirësitë e përjetuara gjatë periudhës së fundit. Khalid Jamil iu kërkua të komentonte deklaratat e kolegut brazilian. Trajneri i kombëtares indiane zgjodhi të mos e ushqente debatin: “Nuk më intereson. Secili ka të drejtë të ketë opinionin e vet”.

Jamil preferoi ta zhvendoste menjëherë vëmendjen nga gjykimi i teknikut Ancelotti te puna që pret skuadrën e tij. Për trajnerin indian, ndeshjet e ardhshme duhet të shërbejnë mbi të gjitha për të matur nivelin e arritur nga kombëtarja dhe për të identifikuar aspektet ku duhet ndërhyrë: “Objektivi im personal është i thjeshtë: ta përgatis mirë skuadrën dhe të ndihmoj futbollin indian të përparojë. Këto ndeshje do të na tregojnë se në çfarë pike jemi dhe çfarë duhet të përmirësojmë”.



India, tre sfida për t'u matur me futbollin ndërkombëtar

Kalendari do t'i ofrojë teknikut Jamil një mundësi të rëndësishme për ta përballur kombëtaren e tij me kundërshtarë të nivelit ndërkombëtar. India do të zbresë në fushë më 25 shtator në Bengaluru kundër Panamasë, përpara përballjes me Brazilin më 3 tetor në Kalkutë.

Tre ditë më vonë, po në Salt Lake Stadium, do të mbërrijë edhe Uruguai. Një treshe ndeshjesh veçanërisht e vështirë, e cila do t'i mundësojë kombëtares indiane të përballlet me tre realitete të ndryshme futbollit. Për Jamil, më shumë sesa deklaratat e trajnerëve të tjerë, do të jetë mbi të gjitha fusha ajo që do të japë përgjigjet për nivelin real të skuadrës së tij.



Takime me agjentë serbë?/ Gazetarja Klodiana Lala flet për deklaratën e Viora Hysenit



Viora Hyseni shantazhon publikisht gazetaren Klodiana Lala



Viora Hyseni i jepte garanci Ergys Agasit: Krejt radarët e shtetit i fik për ty



Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...

Të kështilluara



Transformimi i Gjermanisë nga Jurgen Klopp: bën një gjest me dorë dhe e gjithë skuadra bën presing

Barazimi 1-1 mes Gjermanisë dhe Holandës në ndeshjen e parë të Nations League i përcolli këtë mesazh trajnerit të ri të Gjermanisë dhe ish-trajnerit të Liverpool.



Zinedine Zidane befasohet nga një gazetar: “Për mua është një ëndërr të jem këtu, a ma jepni një autograf?”

Emocionet e Zinedine Zidane, që pritet të debutojë me Francën, nuk ishin të vetmet në sallën e konferencës për shtyp, pasi edhe disa nga të pranishmit iu dorëzuan magjepsjes së kampionit të madh.



Inter, shifra rekord: 518 milionë euro të ardhura, rezultati i dytë më i mirë në histori, e 22,7 milionë fitim



Stekë bilardo apo pushkë? Lojtari i Izraelit Abu Farchi përjashtohet e pas polemikave sqaron festimin e tij

Një festim që i kushtoi një ndeshje dhe që ndezi debatin. Kush e di nëse Abu Farchi, sulmuesi i Izraelit i lindur në vitin 2006, kishte menduar të krijonte gjithë këtë kaos me një gjest kaq të zakonshëm për të.



Klopp ‘tradhtohet’ nga Gakpo, Holanda eviton rënien me Gjermaninë: Haaland udhëheq Norvegjinë, Felix Portugalinë

Nations League 2026/27 nis me barazimin 1-1 mes Gjermanisë dhe Holandës, në ndeshjen e madhe që shënon edhe debutimin e Klopp dhe Xavi në pankinat e Mannschaft dhe Oranje




Muriqi shemb Irlandën e tregon fanellën e UÇK-së: në “Fadil Vokrri” Kosova dominon totalisht Irlandën

Kosova mposhti Irlandën 1-0 mbremjen e sotme në Prishtinë, në stadiumin “Fadil Vokrri”. Kjo ndeshje shënoi takimin hapës për të dyja skuadrat në Grupin B3 të UEFA Nations League





Cristiano Ronaldo refuzoi pagën e parë në Arabi që të paguheshin shokët e skuadrës: kishin 6 muaj pa marrë rrogë



Rrëfimi tronditës i Andy Carroll: "Pësova dhunë sek*uale nga një mik i famshëm. E gjeta në shtratin tim"

Për herë të parë Andy Carroll është hapur me sinqeritet për momentin më të keq të jetës së tij, duke zbuluar se ka pësuar një sulm seksual në vitin 2021.



Matthäus dhe e dashura 27-vjeçare pas pesë martesash e pesë divorcesh: "E sigurtë, nuk do të martohem më"

Pesë martesë, pesë divorce dhe katër fëmijë mund të jenë të mjaftueshme. Lothar Matthäus e ka vendosur tashmë se cili do të jetë hapi i radhës në jetën e tij sentimentale në moshën 65-vjeçare: nuk do të ketë një të gjashtë.



Alaba dhe karrigia e bardhë: historia e çuditshme e lindur te Reali që e bëri të famshëm festimin e tij

Më 23 majin e kaluar, kundër Athletic Bilbao, ai luajti ndeshjen e tij të fundit me "Los Blancos" dhe vendosi ta përshëndeste publikun në fushë me një karrigë të bardhë.

Me sytë katër



23:13

PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

Deputeti i Partisë Socialiste Bledi Çuçi ka qenë "viktima" e radhës e protestuesve në Tiranë, të cilët i kanë...



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44



Kryemadhi: Si nuk i fiku njeri radarët për ne! Meta vetëm i ndizte

26:36



PAMJET VIRALE/ Presidenti i Haitit pi ujë me kanë në mes të OKB-së

22:43



PAMJET/ Rrëzohet gjatë stërvitjes në Uells avioni ushtarak britanik

21:28

SPORT

→ Të tjerë artikuj



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.